



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.330/ 12 prot.

Datë 17.04.2025

V E N D I M

Nr. 530/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiovent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 17.04.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga BOE “Erald” SHPK dhe “Lis Konstruktion” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar, me Nr. REF-24857-10-16-2024, me objekt: “Arredim/mobilim i ambjenteve të brendshme të godinave (Fakultet dhe mensë-kuzhinë) të Kampusit të Ri të Akademisë së Forcave të Armatosura” me fond limit 110.154.899 (njëqind e dhjetë milion e njëqind e pesëdhjetë e katër mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH ose 1.115.041 (një milion e njëqind e pesëmbëdhjetë mijë e dyzet e një) euro pa TVSH, zhvilluar në datën 30.12.2024, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

Ankimues:

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Klame” SHPK me NIPT K21518003F dhe “Kevin Konstruktion” SHPK me NIPT K71401004E dhe adresë: Rruga “Gani Kryeziu”, Nr.23, Kati i dytë Tirane, Njesia Administrative 11, Kodër Kamëz

Autoriteti Kontraktor:	Operatori i Blerjeve te Perqendruara SHA Adresë: Rruga “Reshit Çollaku”, Godina nr. 6/337, (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë.
Subjekte të Interesuara:	Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Erald” SHPK me NIPT J74517205P dhe “Lis Konstruksion” SHPK me NIPT K66613407H dhe adresë: Rruga Nacionale Tirane – Fushe Kruje, km 13, ndertese private 1 kateshe, zona kadastrale 3096, me nr. pasurie 97/30, Qerekë, Nikël Krujë.
Baza Ligjore:	Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I 1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.2. BOE ankimues ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. BOE ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 17.10.2024, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*, me Nr. REF-24857-10-16-2024, me objekt: “*Arredim/mobilim i ambjenteve të brendshme të godinave (Fakultet dhe mensë-kuzhinë) të Kampusit të Ri të Akademisë së Forcave të Armatosura*” me fond limit 110.154.899 (njëqind e dhjetë milion e njëqind e pesëdhjetë e katër mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH ose 1.115.041 (një milion e njëqind e pesëmbëdhjetë mijë e dyzet e një) euro pa TVSH, zhvilluar në datën 30.12.2024, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

II.2. Në datën 30.12.2024, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si sistemit të prokurimeve elektronike, rezulton, se në datën 16.01.2025, është bërë klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, duke i njoftuar me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike për vlerat (pa TVSH), si më poshtë:

1. “Muça” shpk	0	lekë	skualifikuar
2. BOE “Erald” shpk & “Lis Konstruksion” shpk	95,816,840	lekë	kualifikuar
3. “Erzeni/SH” shpk	100,198,744.30	lekë	skualifikuar
4. BOE “M. Lezha” shpk & “GBK” shpk	101,348,161	lekë	skualifikuar
5. BOE “Klame” shpk & “Kevin Konstruksion” shpk	101,685,919	lekë	kualifikuar
6. “Ro – Al” shpk	104,688,405	lekë	skualifikuar

II.4. Referuar sistemit të prokurimit elektronik rezulton, se më datë 23.01.2024, është publikuar njoftimi i fituesit paraprak.

II.5. Në datën 03.02.2025 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/5022 dhe me nr.330/2025 prot., datë 04.02.2025 e BOE “Klame” SHPK dhe “Kevin Konstruksion” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*, me Nr. REF-24857-10-16-2024, me objekt: “*Arredim/mobilim i ambjenteve të brendshme të godinave (Fakultet dhe mensë-kuzhinë) të Kampusit të Ri të Akademisë së Forcave të Armatosura*” me fond limit 110.154.899 (njëqind e dhjetë milion e njëqind e pesëdhjetë e katër mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH ose 1.115.041 (një milion e njëqind e pesëmbëdhjetë mijë e dyzet e një) euro pa TVSH, zhvilluar në datën 30.12.2024, nga autoriteti

kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga BOE “Erald” SHPK dhe “Lis Konstruktion” SHPK. Konkretisht BOE ankimues pretendon se:

“1. Nuk kane paraqitur sipas afatit ne tender Sigurim oferte.

2. Shoqeria Lis dhe shoqeria Erald nuk ka plotesuar Pjesen II: Shkaqet e përjashtimit A: Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit sic kerkohet nga ligji.

3. BOE nuk i mbulon te gjithë zerat qe ka tenderi me dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

4. BOE nuk ka paraqitur certifikatë, që të vërtetojë kualifikimin profesional të punonjesve nga nje subjekt i akredituar apo i licencuar per,

- Marangoz 2 (dy)*
- Montues prodhime druri 2 (dy)*
- Bojaxhi per prodhime druri 1 (nje)*
- Elektracist 2 (dy)*
- Suvatues 1 (një)*
- Saldator 1 (një)*
- Shofer 1 (një)*

5. BOE nuk ka paraqitur certifikata ISO nga nje subjekt i akredituar.

6. BOE operatori ekonomik “Erald” shpk nuk ka “Certifikaten e Cilesise/Konformitetit” te produktit per artikujt: - Karrige me rrota, certifikuar ne perputhje me standardin SSH EN 1335-1:2020/A1:2022 (Mobilje zyre - Karrige pune per zyra - Pjesa 1: Dimensionet); SSH EN 1335-2:2018 (Mobilje per zyra - Karrige per zyre - Pjesa 2: Kerkesat e sigurise); SSH EN 16139:2013/AC:2013 (Mobilje - Qendrueshmeria,fortesia dhe siguria - Kerkesat per ndenjeset jo – shtepiake); e njevlefshme ose e perditesuar. - Karrige student, certifikuar ne perputhje me standardin SSH EN 1729-1:2015; SSH EN 1729-2:2012+A1:2015 (1729:2-2023) (SSH EN 1729-1:2015 Mobilje - Karrige dhe tabela për institucionet arsimore - Pjesa 1: Përmasat funksionale, SSH EN 1729-2:2012+A1:2015 (1729:2-2023) Mobilje - Karrige dhe tabela për institucionet arsimore - Pjesa 2: Kërkesat e sigurisë dhe metoda prove) e njevlefshme ose e perditesuar. - Dollap i larte, certifikuar ne perputhje me standardin DS CEN/TR 14073-1:2004; SSH EN 14073-2:2004 DS CEN/TR 14073-1:2004; SSH EN 14073-3:2004; SSH EN 14074:2004 (DS CEN/TR 14073-1:2004Mobilje zyrash - Ruajtja e mobiljeve - Pjesa 1: Përmasat SSH EN 14073-2:2004 Mobileri për zyra - Mobileri për ruajtje - Pjesa 2: Kërkesat e sigurisë SSH EN 14073-3:2004 Mobileri për zyra - Mobileri për ruajtje - Pjesa 3: Metodot e proves për përcaktimin e qëndrueshmërisë dhe të rezistencës së structures SSH EN 14074:2004 Pajisje për zyrat - Tavolina dhe tavolina pune dhe mobileri për ruajtje - Metodot e proves për përcaktimin e

rezistencës dhe kohëzgjatjen e pjesëve të lëvizshme) e njeveleshme ose e perditesuar Tavoline studenti certifikuar ne perputhje me standardin SSH EN 1729-1:2015; SSH EN 1729-2:2012+A1:2015 (1729:2-2023) (SSH EN 1729-1:2015 Mobilje - Karrige dhe tabela për institucionet arsimore - Pjesa 1: Përmasat funksionale, SSH EN 1729-2:2012+A1:2015 (1729:2-2023) Mobilje - Karrige dhe tabela për institucionet arsimore - Pjesa 2: Kërkesat e sigurisë dhe metoda prove e njeveleshme ose e perditesuar. - Profil alumini certifikuar ne perputhje me standardin SSH EN 15088:2005 Alumini dhe lidhje alumini - Produkte strukture për punime konstruktive - Kushte teknike për inspektim dhe shpërndarjeShenim: Per te gjitha certifikatat e mesiperme, operatori ekonomik mund te paraqese certifikata ekuivalente ose te perditesuara me ato, sipas standarteve SSH/EN mbi konformitetin e standarteve europiane dhe te leshuara nga organizma te vleresimit te konformitetit te akredituara ne Republiken e Shqiperise.

7. BOE operatori “Erald” shpk nuk ka as dosje teknike te testimeve me shoqeruar me Raportin e Testimit korrespondues per mallrat e procedures sipas specifikimeve dhe permasave te dst.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 330/1 datë 04.02.2025, lidhur me kriteret kualifikuese për të cilat ankimuesi pretendohet se nuk përmbushen nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Erald” SHPK & “Lis Konstruksion” SHPK.

II.7. Me shkresën nr. 1787/20 prot., datë 07.02.2025, protokolluar me tonën me nr. 330/2 prot., datë 10.02.2025, (ardhur nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike) si dhe shkresës nr. 1787/21 prot, datë 10.02.2025, protokolluar me tonën me nr. 330/3 prot, datë 11.02.2025 (ardhur nëpërmjetë shërbimit postar) autoriteti kontraktor ka dërguar në sistemin elektronik të ankesave, informacion si dhe aktin e trajtimit të ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Klame” SHPK dhe “Kevin Konstruksion” SHPK ku ka vendosur refuzimin e ankesës duke argumentuar si më poshtë vijon: “II.5. Operatori ekonomike “Klame” sh.p.k ka paraqitur ankese nepermjet sistemit te ankesave elektronike te Komisionit te Prokurimit Publik nepermjet portalit e-Albania prane Operatorit te Blerjeve te Perqendruara, njoftuar online tek rubrika “Mesazhet e mia” date 04.02.2025 ora 08:28:58, ankesë e cila eshte protokolluar me tonën me nr. 1787/18 prot, date 04.02.2025, dhe prane Komisionit te Prokurimit Publik me date te aplikimit te ankesës online: 03-02-2025 ora 19:04:22, nr. aplikimi te ankeses online: A/2025/5022 dhe numër protokolli 330/2025 date 04.02.2025, per proceduren e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e larte monetary”, me Nr. REF-24857-10-16-2024, me objekt: “Arredim/mobilim i ambjenteve te brendshme te godinave (Fakultet dhe mense-kuzhine) të 1 Kampusit te Ri te Akademisë se Forcave te Armatosura”, me fond limit 110,154,899.00 leke pa TVSH, zhvillar ne daten 30.12.2024, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

II.6. Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 "Afatet për ankimim" të Ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik", parashikohet shprehimisht se: "2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e verësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimit të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë. 7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtroj më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. 8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohezgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie në shtunë, të diel ose në ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.". Në nenin 111, pika 1, të Ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik", parashikohet shprehimisht se: "1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. ...". Neni 112, pikat 1 dhe 2 të Ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik", parashikon shprehimisht se: "1. Me marrjen e ankesës, autoriteti ose enti kontraktor konfirmon në databazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik që ankesa është paraqitur pranë kësaj institucioni. Nëse autoriteti ose enti kontraktor konstaton se ankesa nuk është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, e refuzon atë si të pavlefshme. 2. Pasi konfirmon se ankesa është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, autoriteti ose enti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik. 3. Komisioni i Prokurimit Publik, me marrjen e ankesës në përputhje me këtë ligj, e publikon në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të pakten të dhëna për: a. ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b. të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër referencë, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës)".

II.7. Në nenin 94, pika 2 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, përcaktohet se "2. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike". Në nenin 97 pika 5 përcaktohet "Në llogaritjen e afateve për paraqitjen e ankesës sipas përcaktimeve në këtë nen nuk do të përfshihet dita e publikimit të njoftimeve prkatëse".

II.8. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës gjykon se, afati për të ushtruar të drejtën e ankimit për këtë procedurë prokurimi objekt ankimi është 10 ditë, duke filluar numërimi nga dita e nesërme e publikimit të njoftimit të fituesit paraprak. Në rastin konkret, referuar verifikimeve të kryera në Sistemin e Prokurimit Elektronik, rezulton, se në datën 23.01.2025 nga ana e autoritetit kontraktor është publikuar njoftimi i fituesit paraprak në SPE për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

Nga verifikimi i kryer nga KSHA u konstatua se, në sistemin e-albania të Operatorit të Blerjeve të Përqendruara, ka mbëritur ankesa e dorëzuar pranë KPP-se me numër A/2025/5022 e operatorit ekonomik "Klame" shpk më 04.02.2025, ndëkohë nga verifikimi në Sistemin

Elektronik të Ankesave të Komisionit të Prokurimit Publik rezulton se pranë këtij të fundit është administruar nepermjet këtij sistemi ankesa me datë aplikimi të ankesës online 03.02.2025 ora 19:04:22, me numër ankimi elektronik A/2025/5022 dhe me nr. 330 prot., datë 04.02.2025, për procedurën e prokurimit të sipërcituar. Pra rezulton se ankimi i operatorit Klame pranë KPP është dorëzuar në datën 03.02.2025 ndërsa Autoriteti Kontraktor është vënë në dijeni në datën 04.02.2025.

KSHA, duke ju referuar afatit ligjor 10 ditë nga dita e nesërme e publikimit të njoftimit të fituesit paraparak në SPE (pa përfshirë ditën e publikimit të njoftimeve perkatëse), nga perlllogaritja e kryer ky afat do të përfundonte në datën 02.02.2025 por, duke qenë se dita e fundit rezultoi ditë pushimi javor (ditë e Diel), afati përfundimtar shtyhet për ditën e nesërme të punës. Referuar kronologjisë së afateve njoftimi i ankesës së shoqërisë Klame shpik duhej të rezultonte në rubrikën “Mesazhet e mia” të Autoritetit kontraktor në portalin e-albania në datën 03.02.2025 brenda ditës normale të punës.

KSHA gjykon se ankimi me mjete elektronike në SEA është konceptuar pikërisht për të shmangur problematikat në perlllogaritje të afateve dhe për të ardhur në ndihmë autoriteteve kontraktore dhe kryesisht operatorëve ekonomikë për të dorëzuar ankesat e tyre pa u kushtëzuar nga kohezgjatja ditore normale e punës apo ditët e festave dhe pushimit javor. Thënë ndryshe, përkimi i ditës së fundit të paraqitjes së ankesës me një ditë feste kombëtare apo ditë pushimi javor, nuk e pengon operatorin ekonomik të ngarkojë në sistemin Elektronik të Ankesave formularin e ankesës dhe ta dërgojë njëherësh pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Dita pasardhëse e punës, duhet konsideruar nga palët si mundësi që ligjvënësi i jep operatorit ekonomik të garantohet për dorëzimin në kohë dhe të saktë apo të plotë të ankesës, duke u siguruar edhe për mbërritjen e saj brenda kohëzgjatjes ditore të punës në AK dhe KPP, madje edhe për publikimin e saj nga KPP në sistem. Fakti që ligjvënësi i ka dhënë mundësinë ankimesit në rastet kur dita e fundit e ankimit bie në ditë festash zyrtare apo pushimi javor, të dërgojë ankesën ditën e nesërme të punës, nuk do të thotë që ankimesi të keqpërdorë afatin kohor të ditës së punës pasi kuptohet qartë që në këtë rast shtyrja merr kuptim për atë pjesë të ditës së punës që i referohet ditës normale të punës, që në rastin konkret për AK dhe KPP është orari zyrtar i punës.

Duke mbajtur në konsideratë faktin që, sipas LPP dhe Rregullave të Prokurimit Publik, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraparak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimiti, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në thell të ankimit, në rastin konkret, ankimi administrativ i paraqitur nga OE ankimes nuk mund të konsiderohet si ezaurim i afateve ligjore që duhet të ndjekë një ankim administrativ, pasi ankimi është realizuar jashtë afatit të ankimit.

Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimes “Klame” shpik, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, ndaj përmbën shkak për mospranimin e tij. KSHA gjykon se, për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve është i një rëndësie thelbësore, e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës dhe kohëzgjatjen e saj.

Për keto arsye

Bazuar në nenin 114 ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 102 të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës,

Vendosi

- *Refuzimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Klame” shpk.*
- *Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marre ankimuesin, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.*
- *Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marre Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.*
- *Ky vendim i njoftohet menjehere Titullarit të Organit Qëndror Blerës.*

II.8. Me shkresën nr. 330/4 prot., datë 24.02.2025 me objekt “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e BOE “Klame” SHPK & “Lis Konstruktion” SHPK, Komisioni Prokurimit Publik ju drejtua autoritetit kontraktor mbi detyrimin e këtij të fundit për të dërguar në KPP të plotë në original ose kopje të njësuar me origjinalin dokumentacionin e paraqitur nga BOE “Erald” SHPK dhe “Lis Konstruktion” SHPK pranë autoritetit kontraktor sipas parashikimeve të pikes 6 të nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

II.9. Me shkresën nr. 1787/23 prot., datë 27.02.2025 protokolluar me tonën me nr. 330/5 prot., datë 28.02.2025 autoritet kontraktor ka vënë në dispozicion të KPP dokumentacionin e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Erald” SHPK dhe “Lis Konstruktion” SHPK.

II.10. Me datë 28.02.2025 përmes komunikimit elektronik zyrtar (e-mail) bashkimi i operatorëve ekonomik ankimues ka paraqitur në adresën zyrtare të Komisionit Prokurimit Publik argumente për kundërshtimin e vendimit të KSHA-së së autoritetit kontraktor me nr. 1787/21 prot., datë 10.02.2025 për trajtimin e ankesës së tyre, të cilat u protokolluan nga ana KPP-së me nr. 330/6 prot., datë 17.03.2025.

II.11. Me shkresën nr. 330/7 prot., datë 02.04.2025 me lëndë “Kërkesë për informacion” KPP ju drejtua Raiffeisen Bank me kërkesën si vijon: “[...]Në kuadër të shqyrtimit të një ankese të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, Komisionit i shfaqet e nevojshme dhënia e informacionit nga ana juaj si vijon: “Sa është afati i përcaktuar në garancinë bankare për mandat pagesën bashkëlidhur kësaj shkrese dhe nëse nuk është përcaktuar afat cila është procedura e tërheqjes së garancisë nga ana e operatorit ekonomik?”

Sa më sipër, me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës mbështetur në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar si dhe në vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766 datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, kërkojmë nga ana juaj të na vini në dispozicion, në një kohë sa më të shpejtë të jetë e mundur, informacion lidhur me garancinë bankare të kryer nga operatori ekonomik “Erald” SHPK me NIPT J74517205P.

Bashkëlidhur do të gjeni kopje të mandat pagesës së kryer nga operatori ekonomik “Erald” SHPK me NIPT J74517205P.”.

II.12. Me shkresën nr. 330/8 prot, datë 02.04.2025 me objekt “Venije ne dijeni”, Komisioni Prokurimit Publik ju drejtuar autoritetit kontraktor, bashkimit të operatorëve e ekonomikë ankimues si dhe Agjencisë së Prokurimit Publik, duke i sqaruar se për shkaqe të nevojshme për verifikim, në përputhje me pikën 5 të nenit 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nuk është e mundur dalja me një vendim përfundimtar brenda afatit të parashikuar në ligjin e prokurimit publik.

II.13. Me shkresën nr. 532/1 prot., datë 08.04.2025 me lëndë “Kthim përgjigje” protokolluar me tonën me nr. 330/9 prot., datë 09.04.2025 Raiffeisen Bank ka njoftuar KPP si vijon: “Në përgjigje të shkresës suaj nr. 330/7 prot. date 02/04/2025, prot. me tonën nr. 532 datë 03/04/2025ju sqarojmë sa më poshtë: Nga ana e Raiffeisen Bank sh.a. nuk është lëshuar ndonje Garanci Bankare me kërkesë të operatorit ekonomik “Erald” sh.p.k. Dokumenti bankar “Njoftim Debitimi” datë 28.12.2024, qe është dërguar bashkëngjitur shkresës suaj, vërteton faktin se nga llogaria e shoqërisë “Erald” sh.p.k., me NIPT J74517205P, është kryer transfera e shumës prej 2,203,098 lekë, në llogarinë e Operatorit të Blerjeve të Përqëndruara, pranë Credins Bank, me përshkrimin “ERALD, NIPT J74517205P, Lik. për sig. oferte, obj. Arr./mob i amb të brënd të god., (Fak dhe mens-kuzh) REF60160485668”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton

III.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të BOE ankimues, vlen të theksojmë se, për sa i përket pretendimit të autoritetit kontraktor të paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik se: “[...] Nga verifikimi i kryer nga KSHA u konstatua se, në sistemin e-albania të Operatorit të Blerjeve të Përqëndruara, ka mbëritur ankesa e dorëzuar prane KPP-se me numër A/2025/5022 e operatorit ekonomik “Klame” shpk më 04.02.2025, ndëkohë nga verifikimi në Sistemin Elektronik të Ankesave të Komisionit të Prokurimit Publik rezulton se pranë këtij të fundit është administruar nëpermjet këtij sistemi ankesa me datë aplikimi të ankesës online 03.02.2025 ora 19:04:22, me numër ankimi elektronik A/2025/5022 dhe me nr. 330 prot., date 04.02.2025, për

procedurën e prokurimit të sipërcituar. Pra rezulton se ankimi i operatorit Klame pranë KPP është dorëzuar në datën 03.02.2025 ndërsa Autoriteti Kontraktor është vënë në dijeni në datën 04.02.2025. KSHA, duke ju referuar afatit ligjor 10 dite nga dita e nesërme e publikimit të njoftimit të fituesit paraprak në SPE (pa përfshirë ditën e publikimit të njoftimeve perkatëse), nga perlllogaritja e kryer ky afat do të përfundonte në datën 02.02.2025 por, duke qenë se dita e fundit rezultoi ditë pushimi javor (ditë e Diel), afati përfundimtar shtyhet për ditën e nesërme të punës. Referuar kronologjisë së afateve njoftimi i ankesës së shoqërisë Klame shpk duhej të rezultonte në rubrikën "Mesazhet e mia" të Autoritetit kontraktor në portalin e-albania në datën 03.02.2025 brenda ditës normale të punës. KSHA gjykon se ankimimi me mjete elektronike në SEA është konceptuar pikerisht për të shmangur problematikat në perlllogaritje të afateve dhe për të ardhur në ndihmë autoriteteve kontraktore dhe kryesisht operatorëve ekonomikë për të dorëzuar ankesat e tyre pa u kushtëzuar nga kohezgjatja ditore normale e punës apo ditët e festave dhe pushimit javor. Thënë ndryshe, përkimi i dites së fundit të paraqitjes së ankesës me një ditë feste kombëtare apo ditë pushimi javor, nuk e pengon operatorin ekonomik të ngarkojë në sistemin Elektronik të Ankesave formularin e ankesës dhe ta dërgojë njëherësh pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. Dita pasardhëse e punës, duhet konsideruar nga palët si mundësi që ligjvëneshi i jep operatorit ekonomik të garantohet për dorëzimin në kohë dhe të saktë apo të plotë të ankesës, duke u siguruar edhe për mbërritjen e saj brenda kohëzgjatjes ditore të punës në AK dhe KPP, madje edhe për publikimin e saj nga KPP në sistem. Fakti që ligjvëneshi i ka dhënë mundësinë ankimesit në rastet kur dita e fundit e ankimit bie në ditë festash zyrtare apo pushimi javor, të dërgojë ankesën ditën e nesërme të punës, nuk do të thote që ankimesi të keqpërdorë afatin kohor të ditës së punës pasi kuptohet garte që në këtë rast shtyrja merr kuptim për atë pjesë të ditës së punës që i referohet ditës normale të punës, që në rastin konkret për AK dhe KPP është orari zyrtar i punës. Duke mbajtur në konsideratë faktin që, sipas LPP dhe Rregullave të Prokurimit Publik, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimiteti, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në thellësi të ankimit, në rastin konkret, ankimi administrativ i paraqitur nga OE ankimes nuk mund të konsiderohet si e zaurim i afateve ligjore që duhet të ndjekë një ankim administrativ, pasi ankimi është realizuar jashtë afatit të ankimit [...]" KPP vëren se BOE ankimes ka paraqitur ankim në lidhje me procedurën e mësipërme të prokurimit, si pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike me datë 03.02.2025. Me dorëzimin e ankesës në sistemin elektronik, në përputhje me afatet në ligjin 162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, ankesa konsiderohet menjëherë e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, njëkohësisht në të dyja institucionet. Ankesa dhe e gjithë përmbajtja e saj është e aksesueshme nga autoriteti kontraktor, në Sistemin Elektronik të Ankesave. Në nenin 110, pikat 2 dhe 8 "Afatet për ankimim" i ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "2.Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimit të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në Sistemin Elektronik të Ankesave.

Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për procesin e vlerësimit të ofertave, është 10 ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit ose i njoftimit të anulimit. Në rastin konkret referuar verifikimeve në Sistemin e Prokurimit Elektronik, si dhe informacionit të dërguar nga ana e autoritetit kontraktor rezulton, se njoftimi i fituesit paraprak është publikuar më datë 23.01.2025. KPP vëren, se BOE ankimues me datë 03.02.2025, ka paraqitur ankesë në sistemin e ankesave elektronike njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor. Referuar parashikimeve të sipërcituara, në rastin konkret, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nis ditën e publikimit të njoftimit të fituesit më datë 23.01.2025 dhe përfundon në ditën e 10-të. Në rastin konkret, afati i fundit për paraqitjen e ankesës në autoritetin ose entin kontraktor, si dhe njëkohësisht në Komisionin e Prokurimit Publik, referuar datës së publikimit të njoftimit të fituesit paraprak, ka qenë data 01.02.2025, por duke qenë se dita e fundit e këtij afati ishte ditë pushimi (e shtunë) sipas urdhërimeve të nenit 110 pika 2 të lex specialis ky afat mbaron në ditën e punës që vjen pas saj pra me datë 03.02.2025. Lidhur me pretendimet e KSHA-së së autoritetit kontraktor se ankesa është paraqitur më datën 03.02.2025 ora 19:04:22 pra jashtë orarit zyrtar të punës ky pretendim nuk qëndron pasi Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin se afatet procedurale caktohen nga Kodi i Procedurës ose nga ligje të veçanta. Kohëzgjatja në të cilin një akt procedural duhet të realizohet (në rastin konkret afati i paraqitjes së ankimit kundër vendimit të KVO-së), shprehet sipas rastit në ditë, muaj apo vite. *Lex specialis* afatet e ankimit i ka llogaritur në ditë dhe ky afat në rastin konkret fillon nga dita e publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe përfundon në ditën e 10-të. Në këtë kuadër ankesa e dorëzuar në KPP dhe autoriteti kontraktor përmes sistemit të ankesave elektronike në ditën pasardhëse të punës me datë 03.02.2025 pasi dita e fundit e afatit (datë 01.02.2025) ishte ditë pushimi (e shtunë) pavarësisht se është paraqitur jashtë orarit zyrtar konsiderohet si e paraqitur brenda afatit në kuptim të nenit 110 pika 2 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar. KPP gjithashtu gjen me vend të theksojë se, ndërsa çdo subjekt i LPP ka të drejtë të interpretojë dispozitat e këtij legjislacioni, po ashtu, këto subjekte kanë edhe detyrimin ta interpretojnë atë në përputhje e harmoni të brendshme dhe të jashtme me legjislacionin tjetër në fuqi në Republikën e Shqipërisë por edhe me Kushtetutën si ligji më i lartë në vend referuar parashikimeve të nenit 4/2 të saj. Kushtetuta vetë parashikon hierarkinë, statusin dhe efektin e normave ligjore. Kuadri kushtetues ka parashikuar hierarkine e normave ligjore në nenin 116 të Kushtetutës në të cilin parashikohet se: “1. Aktet normative që kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë janë:

a) Kushtetuta;

b) marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara;

c) ligjet;

ç) aktet normative të Këshillit të Ministrave.

2. Aktet që nxirren nga organet e pushtetit vendor kanë fuqi vetëm brenda juridiksionit territorial që ushtrojnë këto organe.

3. Aktet normative të ministrave dhe të organeve drejtuese të institucioneve të tjera qendrore kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë brenda sferës së juridiksionit të tyre.”

Në këtë kuadër Kushtetuta vetë, duke folur për hierarkinë e akteve normative në nenin 116 të saj, parashikon akte normative që janë “nën” ligjet siç është në rastin konkret VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Në këtë mënyrë, duke qenë se ligjet kanë epërsi mbi aktet normative të Këshillit të Ministrave, KPP në vendimarrjen e tij i qëndron strikt këtij rregullimi si organi më i lartë në fushën e prokurimit publik, i cili ka të drejtën dhe përgjegjësinë të bëjë interpretimin përfundimtar të legjislacionit të fushës përkatëse duke llogaritur afatet e ankimit të operatorëve ekonomikë sipas parashikimeve të nenit 110 pika 1 dhe 2 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

III.1.1. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues se bashkimi i operatorëve ekonomik “Erald” SHPK & “Lis Konstruktion” SHPK nuk kane paraqitur sipas afatit në tender Sigurim oferte, Komisioni Prokurimit Publik vëren se,

III.1.2. Në shtojcën 8/2, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 1 gërma “b” në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar si më poshtë vijon:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

III.1.3. Në seksionin 3 “Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike” pika 3.1 dhe 3.2 të “Njoftimit të kontratës” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, të publikuara në SPE, autoriteti kontraktor ka parashikuar si më poshtë vijon:

Seksioni 3: Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike

3.1 Sigurimi i ofertës: (e zbatueshme në rastin e procedurave të prokurimit me një vlerë më të lartë se se prokurimi me vlerë të vogël).

Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor, në bazë të diskrecionit të tij, mund të kërkojë sigurimin e ofertës edhe për procedurat nën kufirin e lartë monetar.

Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 4.

Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës është 2.203.097,98 (dy milion e dyqind e tre mijë e nëntëdhjetë e shtatë presje nentëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH ose 22.300,8 (njëzet e dy mijë e treqind presje tetë) euro pa TVSH.

Kursi këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 16.10.2024

Në rastet e paraqitjes së ofertave për Lote të veçanta, vlera e sigurimit të ofertës për secilin Lot do të jetë si më poshtë:

Loti 1 _____ (shuma,monedha)

Loti 2 _____ (shuma monedha)

3.1.2 Autoriteti/Enti kontraktor pranon vlerën e pagesës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit/entit kontraktor _____ (të shënohet numri i llogarisë bankare të autoritetit ose entit kontraktor)

Nr.	Banka	Nr. llogarise
1	Credins	AL91 2121 1009 0000 0000 0203 2030

3.1.3 Autoriteti/Enti kontraktor pranon pagesën e vlerës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi edhe në formën:

i. garancisë bankare x

ose

ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente

3.2 Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 250 (dyqind e pesëdhjetë) ditë

III.1.4. Në shtojcën 4 “Formulari i Sigurimit të Ofertës”, pjesë e dokumentave të tenderit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka parashikon shprehimisht:

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.

** * **

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;*
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;*
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.*

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

III.1.5. Nga verifikimet e kryera nga KPP në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se bashkimi i operatorëve ekonomik “Erald” SHPK dhe “Lis Konstruktion” SHPK në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

1. Deklaratë Formulari i Sigurimit të ofertës në emër të “Erald” SHPK për Operatorin e Blerjeve të Përqëndruara në të cilin parashikohet se: “[...] Ne vërtetojmë se Erald sh.p.k ka transferuar në llogari të “Operatorit Të Blerjeve të Përqëndruara”, Tiranë në Bankën Credins, Numrin e llogarisë AL91 2121 1009 0000 0000 0203 2030 shumën 2.203.098 (Dymilion e dyqind e tre mijë e nëntë dhjetë e tetë) lekë si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

.....

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [250 ditë].”

2. Pagesën bankare të datës 28.12.2024 me referencë të pagesës P241230ADNVOP08 pranë Raiffeisen Bank me klient urdhërues “Erald” SHPK, ku shuma e urdhëruar është

2,203,098.00 lekë dhe me detaje të pagesës: *ERALD, NIPT J74517205P, Lik. per sig. oferte, obj. Arr./mob i amb te brend te god.,(Fak dhe mens-kuzh) RE F60160485668 dhe klient përfitues Operatorin e Blerjeve të Perqendruara*”

III.1.6. Në nenin Neni 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme

njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.1.7. Në neni 83, pika 1 dhe 2 “Sigurimi i ofertës” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se:

“1. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, ndërkohë që mund të kërkojë paraqitjen e këtij sigurimi edhe në procedurat nën kufirin e lartë monetar, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

2. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllëgoaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës.

Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor pranon mundësinë e pagesës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor. Përveç kësaj forme të paraqitjes së sigurimit të ofertës, autoriteti ose enti kontraktor, sipas vlerësimit të tij, duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit mundësinë e paraqitjes së sigurimit të ofertës:

i. në formën e garancisë bankare; ose

ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente.”.

III.1.8. Në nenin 94 “Vlefshmëria e ofertave”, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” , i ndryshuar, parashikohet shprehimisht:

1. Ofertat janë të vlefshme gjatë periudhës kohore të specifikuar në dokumentet e tenderit. 2. Autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve ta zgjasin këtë periudhë për një afat të caktuar dhe zgjatja bëhet vetëm me pëlqimin e palës. Në këtë rast: a) ofertuesi mund të refuzojë kërkesën, pa humbur sigurimin e ofertës dhe vlefshmëria e ofertës së tij përfundon me mbarimin e periudhës fillestare të vlefshmërisë; b) kur ofertuesi pranon zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë, me të zgjatet edhe sigurimi i ofertës apo paraqitet një sigurim i ri oferte, që mbulon periudhën e zgjatur të vlefshmërisë. Ofertuesi, që nuk zgjat

periudhën e sigurimit të ofertës ose që nuk paraqet një sigurim të ri oferte, vlerësohet se e ka refuzuar kërkesën për zgjatje të periudhës së vlefshmërisë së ofertës dhe oferta e tij do të refuzohet.

III.1.9. Në nenin 30 pika 3 “Sigurimi i ofertës” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “3. Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit të kontratës ose lotit. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe.”.

III.1.10. Në nenin 24, pika 8 “Udhëzimet për ofertuesit/kandidatët”, të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, thuhet shprehimisht se: “8. Periudha e vlefshmërisë së ofertës fillon nga momenti i hapjes së ofertave. Në çdo rast, të paktën 5 (pesë) ditë përpara përfundimit të afatit kohor për vlefshmërinë e ofertave, autoriteti/enti kontraktor mund t’i kërkojë ofertuesit, me shkrim, të zgjasë periudhën e vlefshmërisë, deri në një datë të caktuar. Ofertuesi mund ta refuzojë këtë kërkesë me shkrim pa humbur të drejtën për rimbursim të sigurimit të ofertës, kur ka një të tillë. Ofertuesi që bie dakord të zgjasë periudhën e vlefshmërisë së ofertës njofton autoritetin/entin kontraktor me shkrim dhe paraqet një sigurim oferte të zgjatur, nëse ka pasur një të tillë. Oferta nuk mund të modifikohet. Nëse ofertuesi nuk i përgjigjet kërkesës së autoritetit/entit kontraktor, lidhur me zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së ofertës, ose nuk e pranon kërkesën në fjalë, ose nuk paraqet një sigurim të zgjatur të ofertës, kur kërkohet, atëherë autoriteti/enti kontraktor do të refuzojë ofertën.

Nëse autoriteti/enti kontraktor nuk ka bërë një kërkesë me shkrim për operatorin ekonomik që të zgjasë periudhën e vlefshmërisë së ofertës, sipas parashikimit të paragrafit të parë të kësaj pike, atëherë operatori ekonomik nuk mund të penalizohet për këtë mungesë.

III.1.11. Në Seksionin I: **Udhëzime për Operatorët Ekonomikë (Udhëzime)**, gërma “B”, “PËRGATITJA E OFERTAVE”, pika 9, të Dokumentave Standarde të Tenderit, të hartuara nga ana e Agjencisë së Prokurimit Publik dhe të detyrueshme për tu zbatuar nga autoritetet kontraktore, parashikohet si vijon:

Periudha e vlefshmërisë së Ofertës

1. Ofertat do të jenë të vlefshme për periudhën e specifikuar në Njoftimin e Kontrates pas afatit të paraqitjes së Ofertave të përcaktuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor; Oferta për një periudhë më të shkurtër nuk është e vlefshme dhe do të refuzohet.

2. Sigurimi i Ofertës mund të paraqitet në njërën nga format e mëposhtme:

a) Pagesa nga ofertuesi, në vlerë monetare, në llogarinë e

autoritetit/entit kontraktor

b) Garanci bankare

c) Garanci sigurimi

Dokumentet e mësipërme duhet të jenë të vlefshme gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së Ofertës.

3. *Periudha e vlefshmërisë së Ofertës fillon nga momenti i hapjes së ofertave. Në çdo rast, të paktën 5 ditë para përfundimit të afatit të vlefshmërisë së ofertave, Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Ofertuesit me shkrim të zgjasë periudhën e vlefshmërisë, deri në një datë të caktuar. Ofertuesi mund ta refuzojë këtë kërkesë me shkrim, pa humbur të drejtën për rimbursim të Sigurimit të Ofertës, kur ka një të tillë. Ofertuesi që bie dakord të zgjasë periudhën e vlefshmërisë së Ofertës njofton Autoritetin/Entin Kontraktor me shkrim dhe paraqet një sigurim oferte të zgjatur, nëse ka pasur një të tillë. Oferta nuk mund të modifikohet. Nëse Ofertuesi nuk i përgjigjet kërkesës së bërë nga Autoriteti/Enti Kontraktor në lidhje me zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së Ofertës, ose nuk e pranon kërkesën në fjalë, ose nuk paraqet një sigurim të zgjatur të ofertës, kur kërkohet, atëherë Autoriteti/Enti Kontraktor e refuzon Ofertën.*

Nëse autoriteti / enti kontraktor nuk i ka bërë një kërkesë me shkrim operatorit ekonomik për të zgjatur periudhën e vlefshmërisë së ofertës, sipas parashikimit të paragrafit të parë të kësaj pike, atëherë operatori ekonomik nuk mund të penalizohet për këtë, pra sigurimi i ofertës së tij nuk konfiskohet.

III.1.12. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, vërehet se në kriterin kualifikues të pikës 2, të shtojcës 8, “*Kriteret e veçanta të kualifikimit*”, në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar që ofertuesi duhet të paraqesë sigurimin e ofertës, sipas Shtojcës 4 si dhe sipas Seksionit 3: “*Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike*” autoriteti kontraktor ka përcaktuar sigurimit e ofertës, në formën e garancisë bankare një prej formave e cila është e parashikuar dhe në nenin 83 të LPP-së, gjithashtu ka parashikuar edhe vlerën e sigurimit prej **2.203.097,98 (dy milion e dyqind e tre mijë e nëntëdhjetë e shtatë presje nentëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH**, si dhe afatin e vlefshmërisë së sigurimit të ofertës për një periudhë prej 250 ditë.

III.1.13. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që

nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Komisioni Prokurimit Publik konstaton, se referuar dokumentit bankar të dorëzuar nga operatori ekonomik bashkimi i operatorëve ekonomikë “Erald” SHPK dhe “Lis Konstruksion” SHPK është lëshuar në njërën prej formave të përcaktuara në kriterin kualifikues të sipërpërmendur dhe konkretisht pagesë e kryer nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit kontraktor, ku është ngarkuar në SPE dokumenti bankar “njoftim debitimi” i datës 28.12.2024 me referencë të pagesës P241230ADNVOP08 pranë Raiffeisen Bank me klient urdhërues “Erald” SHPK, ku shuma e urdhëruar është 2,203,098.00 lekë dhe me detaje të pagesës: “ERALD, NIPT J74517205P, Lik.per sig. oferte, obj. Arr./mob i amb te brend te god., (Fak dhe mens-kuzh) RE F60160485668 dhe klient përfitues Operatorin e Blerjeve të Perqendruara”.

Nga verifikimi i “dokumentit bankar”, pra sigurimit të ofertës të dorëzuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Erald” SHPK dhe “Lis Konstruksion” SHPK, konstatohet, se ky i fundit është lëshuar në njërën prej formave të përcaktuara në ligjin për prokurimin publik, konkretisht në formën e pagesës nga ofertuesi në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor, por nga ana tjetër konstatohet se ky dokument bankar nuk përmban të gjitha të dhënat e nevojshme të përcaktuara në shtojcën 4, “Formulari i sigurimit të ofertës” të dokumentave të tenderit, siç është dhe periodha e vlefshmërisë për të cilën është i vlefshëm ky sigurim pra 250 ditë.

Për një hetim të thelluar dhe për një gjykim sa më të drejtë të çështjes me shkresën nr. 330/7 prot., datë 02.04.2025 me lëndë “Kërkesë për informacion” KPP ju drejtua Raiffeisen Bank me kërkesën si vijon: “[...]Në kuadër të shqyrtimit të një ankese të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, Komisionit i shfaqet e nevojshme dhënia e informacionit nga ana juaj si vijon: “Sa është afati i përcaktuar në garancinë bankare për mandat pagesën bashkëlidhur kësaj shkrese dhe nëse nuk është përcaktuar afat cila është procedura e tërheqjes së garancisë nga ana e operatorit ekonomik ?”

Sa më sipër, me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës mbështetur në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar si dhe në vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766 datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, kërkojmë nga ana juaj të na vini në dispozicion, në një kohë sa më të shpejtë të jetë e mundur, informacion lidhur me garancinë bankare të kryer nga operatori ekonomik “Erald” SHPK me NIPT J74517205P. Bashkëlidhur do të gjeni kopje të mandat pagesës së kryer nga operatori ekonomik “Erald” SHPK me NIPT J74517205P”. Në përgjigje të kërkesës së sipërcituar të KPP me shkresën nr. 532/1 prot., datë 08.04.2025 me lëndë “Kthim përgjigje” protokolluar me tonën me nr. 330/9 prot., datë 09.04.2025 Raiffeisen Bank ka njoftuar KPP si

vijon: “Në pergjigje te shkresës suaj nr. 330/7 prot. date 02/04/2025, prot. me tonën nr. 532 datë 03/04/2025ju sqarojmë sa më poshtë:

Nga ana e Raiffeisen Bank sh.a. nuk është lëshuar ndonje Garanci Bankare me kërkesë të operatorit ekonomik “Erald” sh.p.k.

Dokumenti bankar “Njoftim Debitimi” datë 28.12.2024, qe është dërguar bashkëngjitur shkresës suaj, vërteton faktin se nga llogaria e shoqërisë “Erald” sh.p.k., me NIPT J74517205P, është kryer transferta e shumës prej 2,203,098 leke, në llogarinë e Operatorit të Blerjeve të Përqëndruara, pranë Credins Bank, me përshkrimin “ERALD, NIPT J74517205P, Lik.per sig.oferte, obj. Arr./mob i amb te brend te god., (Fak dhe mens-kuzh) REF60160485668”.

Sic vihet re institucioni bankar më sipër ka konfirmuar se nga ana e tyre nuk është lëshuar ndonje Garanci Bankare me kërkesë të operatorit ekonomik “Erald” sh.p.k. si dhe dokumenti banker “njoftim debiti” i datës 28.12.2024 që bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimes ka ngarkuar në sistem vërteton se nga llogaria e shoqërisë “Erald” SHPK është kryer transferta në llogari të autoritetit kontraktor në shumën prej 2,203,098 leke me përshkrimin si më sipër, pra nuk vërteton në asnjë moment garanci bankare për sigurimin e ofertës në periudhën e kërkuar në dokumentet e tenderit prej 250 ditësh. Ndodhur në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik thekson se, me të vërtetë ligjvënësi referuar nenit 83 të LPP-së ka përcaktuar format në të cilat mund të kryhet sigurimi i ofertës, por nga ana tjetër ligjvënësi ka përcaktuar edhe formatin e dokumenteve standarde të tenderit të hartuara dhe miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik, të cilat përdoren nga autoriteti kontraktor gjatë procedurave të prokurimi dhe përsa i përket sigurimit të ofertës, në dokumentat e tenderit është përcaktuar që operatori ekonomik duhet të paraqesë sigurimin e ofertës, duke paraqitur shtojcën 4 “Formulari i sigurimit të ofertës” sipas dokumentave të tenderit. Ku kjo shtojcë përcakton qartësisht periudhën e vlefshmërisë prej 250 ditësh.

Sa më sipër arsyetuar, Komisioni gjykon se, me të vërtetë është parashikuar më shumë se një formë për kryerjen e sigurimit të ofertës, por nga ana tjetër është përcaktuar dhe paraqitja e dokumentacionit nga ana e operatorit ekonomik sipas shtojcave të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Akoma më tej Komisioni thekson se, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të gjithë operatorët ekonomikë duhet të jenë në kushte të barabarta si kur përgatisin ofertat e tyre ashtu edhe kur bëhet vlerësimi i tyre. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Komisioni gjykon, se bashkimi i operatorëve ekonomik “Erald” SHPK & “Lis Konstruksion” SHPK me dokumentacionin e dorëzuar nuk ka plotësuar kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.1.b të Shtojcës 8/2 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” të dokumenteve të tenderit.

III.1.14. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë “Erald” SHPK & “Lis Konstruksion” SHPK do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor, deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 75 i LPP-së. Në nenin 75, pika 1 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se “[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit.

Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit [...]”. Komisioni gjykon se është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me kriteret dhe kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, për sa kohë që i kanë pranuar ato dhe nuk i kanë bërë në asnjë rast objekt-ankimimi.

Sa më sipër pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Klame” SHPK & “Kevin Konstruksion” SHPK qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Klame” SHPK & “Kevin Konstruksion” SHPK, mbi kundërshtimin e kualifikimit të bashkimit të operatorëve ekonomik “Erald” SHPK & “Lis Konstruksion” SHPK me pretendimin se: “BOE nuk ka paraqitur certifikata ISO nga një subjekt i akredituar” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 8/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3.10 “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit të modifikuara objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

- ISO 9001:2015 ose ekuivalente, “Per Sistemin e Menaxhimit te Cilesise” (e vlefshme);
- ISO 14001:2015 ose ekuivalente per Sistemin e Menaxhimit te Mjedisit“ (e vlefshme);
- ISO/ 45001:2018 e perditesuar (SSH EN ISO 45001 -2023) ose ekuivalente, “Per Sistemin e Menaxhimit te Shendetit dhe Sigurise ne Pune” (e vlefshme);
- SSH UNI EN ISO 3834-2:2006 ose ekuivalente , “Kerkesat e cilesise per saldimin e materialeve metalike” (e vlefshme).

III.2.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se bashkimi i operatorëve ekonomikë “Erald” SHPK & “Lis Konstruksion” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

1. Çertifikatë ISO 9001:2015 lëshuar nga AQSCERT me nr. të certifikatës AQS/Q/117052024 për subjektin “Erald” SHPK, për fushat e aktiviteteve si vijon *“Projektim, prodhimin dhe tregtim mobilje për zyra, shkolla, hotele etj. Me konstruksion me bazë druri, inoksi dhe metalike, prodhime tapicerie si dhe materiale të buta. Tregtim të artikujve të ndryshëm industrial”*, lëshuar në datën 02.02.2018 dhe me skadencë në datën 08.02.2027;
2. Çertifikatë ISO 14001:2015 lëshuar nga AQSCERT me nr. të certifikatës AQS/A/117062024 për subjektin “Erald” SHPK, për fushat e aktiviteteve si vijon *“Projektim, prodhimin dhe tregtim mobilje për zyra, shkolla, hotele etj. Me konstruksion me bazë druri, inoksi dhe metalike, prodhime tapicerie si dhe materiale të buta. Tregtim të artikujve të ndryshëm industrial”*, lëshuar në datën 02.02.2018 dhe me skadencë në datën 08.02.2027;
3. Çertifikatë ISO 45001:2018 lëshuar nga AQSCERT me nr. të certifikatës AQS/S/117072024 për subjektin “Erald” SHPK, për fushat e aktiviteteve si vijon *“Projektim, prodhimin dhe tregtim mobilje për zyra, shkolla, hotele etj. Me konstruksion me bazë druri, inoksi dhe metalike, prodhime tapicerie si dhe materiale të buta. Tregtim të artikujve të ndryshëm industrial”*, lëshuar në datën 02.02.2018 dhe me skadencë në datën 08.02.2027;
4. Çertifikatë UNI EN ISO 3834-2:2006 lëshuar nga AQSCERT me nr. të certifikatës AQS/QS/117082024 për subjektin “Erald” SHPK, për fushat e aktiviteteve si vijon *“Konstruksione metalike dhe punime me saldim për Projektim, prodhimin dhe tregtim mobilje për zyra, shkolla, hotele etj. Me konstruksion me bazë druri, inoksi dhe metalike, prodhime tapicerie si dhe materiale të buta. Tregtim të artikujve të ndryshëm industrial”*, lëshuar në datën 02.02.2018 dhe me skadencë në datën 08.02.2027;
5. Çertifikatë ISO 9001:2015 lëshuar nga AQSCERT me nr. të certifikatës AQS/Q/116832024 për subjektin “Lis Konstruksion” SHPK, për fushat e aktiviteteve si vijon *“Ndërtime të objekteve civile dhe industriale (rrugë, ura, ujësjellësa, kanlizime vepra kullimi dhe vaditje). Rikonstruksion dhe mirëmbajtje të objekteve civile dhe industriale. Prodhim dhe tregtim i produkteve dhe agregatëve të ndërtimit (beton, asfalt, inerte) dhe materiale të parafabrikuara prej beton/armeje për ndërtim. Tregtim i materialeve të ndërtimit (elektrike, hidraulike dhe vegla pune). Ndërtim i linjave elektrike TN, TM, TU dhe telekomunikacionit, ndërtim i nënstacioneve elektrike TN/TM dhe TM/TU, centrale dhe hidrocentrale, rrjete inxhinierike etj. Sisteme telefonike, televizive, telekomunikacioni dhe CCTV”*, lëshuar në datën 13.02.2018 dhe me skadencë në datën 30.01.2027;

6. Çertifikatë ISO 14001:2015 lëshuar nga AQSCERT me nr. të certifikatës AQS/A/82702022 për subjektin “Lis Konstruksion” SHPK, për fushat e aktiviteteve si vijon “Ndërtime të objekteve civile dhe industriale (rrugë, ura, ujësjellësa, kanlizime vepra kullimi dhe vaditje). Rikonstruksion dhe mirëmbajtje të objekteve civile dhe industriale. Prodhim dhe tregtim i produkteve dhe agregatëve të ndërtimit (beton, asfalt, inerte) dhe materiale të parafabrikuara prej beton/armeje për ndërtim. Tregtim i materialeve të ndërtimit (elektrike, hidraulike dhe vegla pune). Ndërtim i linjave elektrike TN, TM, TU dhe telekomunikacionit, ndërtim i nënstacioneve elektrike TN/TM dhe TM/TU, centrale dhe hidrocentrale, rrjete inxhinierike etj. Sisteme telefonike, televizive, telekomunikacioni dhe CCTV”, lëshuar në datën 08.02.2019 dhe me skadencë në datën 04.02.2025;
7. Çertifikatë ISO 45001:2018 lëshuar nga AQSCERT me nr. të certifikatës AQS/S/82722022 për subjektin “Lis Konstruksion” SHPK, për fushat e aktiviteteve si vijon “Ndërtime të objekteve civile dhe industriale (rrugë, ura, ujësjellësa, kanlizime vepra kullimi dhe vaditje). Rikonstruksion dhe mirëmbajtje të objekteve civile dhe industriale. Prodhim dhe tregtim i produkteve dhe agregatëve të ndërtimit (beton, asfalt, inerte) dhe materiale të parafabrikuara prej beton/armeje për ndërtim. Tregtim i materialeve të ndërtimit (elektrike, hidraulike dhe vegla pune). Ndërtim i linjave elektrike TN, TM, TU dhe telekomunikacionit, ndërtim i nënstacioneve elektrike TN/TM dhe TM/TU, centrale dhe hidrocentrale, rrjete inxhinierike etj. Sisteme telefonike, televizive, telekomunikacioni dhe CCTV”, lëshuar në datën 08.02.2019 dhe me skadencë në datën 04.02.2025;
8. Çertifikatë UNI EN ISO 3834-2:2021 lëshuar nga AQSCERT me nr. të certifikatës AQS/QS/131122024 për subjektin “Konstruksione metalike dhe punime me saldime për Ndërtime të objekteve civile dhe industriale (rrugë, ura, ujësjellësa, kanlizime vepra kullimi dhe vaditje). Rikonstruksion dhe mirëmbajtje të objekteve civile dhe industriale. Prodhim dhe tregtim i produkteve dhe agregatëve të ndërtimit (beton, asfalt, inerte) dhe materiale të parafabrikuara prej beton/armeje për ndërtim. Tregtim i materialeve të ndërtimit (elektrike, hidraulike dhe vegla pune). Ndërtim i linjave elektrike TN, TM, TU dhe telekomunikacionit, ndërtim i nënstacioneve elektrike TN/TM dhe TM/TU, centrale dhe hidrocentrale, rrjete inxhinierike etj. Sisteme telefonike, televizive, telekomunikacioni dhe CCTV”, lëshuar në datën 08.02.2019 dhe me skadencë në datën 04.02.2025;

III.2.3. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: “Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit

publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.2.4. Në nenin 3 Parime të përgjithshme: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.2.5. Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.2.6. Ndërsa në nenin 79, po këtu thuhet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

2. Autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon:

a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara;

b) efikasitetit të energjisë;

c) sistemeve të menaxhimit mjedisor.

3. Në rastet kur operatori ekonomik provon se nuk mund të pajiset me një certifikatë të tillë brenda një kohe të arsyeshme për arsye që nuk varen prej tij, autoriteti ose enti kontraktor mund të pranojë dokumente të tjera, nëpërmjet të cilave mund të provohet garantimi i standardeve të kërkuara. 4. Në çdo rast, certifikatat e kërkuara duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

III.2.7. Në nenin 40, pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

III.2.8. Në nenin 1 “Qëllimi” e ligjit Nr. 116 datë 11.09.2014 “Për Akreditimin e Organeve të Vlerësimit të Konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet:

Ky ligj përcakton rregulla për krijimin, organizimin dhe funksionimin e sistemit të akreditimit të organeve të vlerësimit të konformitetit që kryejnë aktivitete të vlerësimit të konformitetit.

III.2.9. Në nenin 2 “Fusha e zbatimit” e ligjit Nr. 116 datë 11.09.2014 “Për Akreditimin e Organeve të Vlerësimit të Konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet:

Ky ligj zbatohet në çdo rast akreditimi, pavarësisht nëse organi i vlerësimit të konformitetit kryen aktivitete të vlerësimit të konformitetit në fushën vullnetare apo të detyrueshme dhe pavarësisht nëse vlerësimi është i detyrueshëm apo vullnetar.

III.2.10. Në nenin 3 “Përkufizime” e ligjit Nr. 116 datë 11.09.2014 “Për Akreditimin e Organeve të Vlerësimit të Konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet:

“Akreditim” është dëshmia/certifikata e lëshuar nga organizmi kombëtar i akreditimit për organin e vlerësimit të konformitetit, që përmbush kërkesat e përcaktuara në standardet e harmonizuara dhe, sipas rastit, çdo kërkesë shtesë, përfshirë ato të vendosura në skemat përkatëse sektoriale, për kryerjen e një veprimtarie specifike të vlerësimit të konformitetit.

“Organizëm kombëtar i akreditimit” është organizmi i vetëm që kryen akreditimin me autoritetin e dhënë nga ligji. 3. “Certifikatë akreditimi” është një dokument ose një tërësi dokumentesh zyrtare, që deklarojnë akreditimin për një fushë të përcaktuar.

“Vlerësim konformiteti” është procesi që provon nëse janë përmbushur kërkesat e specifikuar për një produkt, proces, shërbim, sistem, person ose organ.

“Organ i vlerësimit të konformitetit” është çdo organ që kryen veprimtari të vlerësimit të konformitetit, përfshirë kalibrimin, testimin, certifikimin dhe inspektimin.

III.2.11. Në nenin 5 “Procesi i Akreditimit” e ligjit Nr. 116 datë 11.09.2014 “Për Akreditimin e Organeve të Vlerësimit të Konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet:

1. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit akrediton:

- a) laboratorë testues, mjekësorë dhe kalibrues;*
- b) organe certifikuese të sistemeve të me- naxhimit;*
- c) organe certifikuese të personelit;*
- ç) organe certifikuese të produkteve;*
- d) organe inspektuese;*
- dh) organe që realizojnë teste zotësie dhe krahasime ndërlaboratorike;*
- e) organe që prodhojnë materiale referuese të certifikuara.*

III.2.12. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin

ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.2.13. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të procedurës objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar që “Operatori ekonomik, duhet të deshmojë se është i pajisur me certifikatat: • ISO 9001:2015 ose ekuivalente, “Per Sistemin e Menaxhimit të Cilesise” (e vlefshme); • ISO 14001:2015 ose ekuivalente per Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit“ (e vlefshme); • ISO/ 45001:2018 e perditesuar (SSH EN ISO 45001 -2023) ose ekuivalente, “Per Sistemin e Menaxhimit të Shendetit dhe Sigurise ne Pune” (e vlefshme); • SSH UNI EN ISO 3834-2:2006 ose ekuivalente , “Kerkesat e cilesise per saldimin e materialeve metalike” (e vlefshme)”. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Erald” SHPK & “Lis Konstruksion” SHPK për përmbushjen e kriterit të mësipërm, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin e përcaktuar në pikën III.2.2 të këtij vendimi. Komisioni i Prokurimit Publik, sa më sipër analizuar, gjykon, se autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, hartimi i dokumenteve të tenderit dhe zhvillimi i procedurës së prokurimit është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt - prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejte me kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit dhe hapat që duhet të ndiqen për përzgjedhjen e ofertës më të mirë, në kuptim të këtij ligji. Nisur nga pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Klame” SHPK & “Kevin Konstruksion” SHPK për bashkimin e operatorëve ekonomikë “Erald” SHPK & “Lis Konstruksion” SHPK se certifikatat ISO të dorëzuara nga ky bashkim operatorësh janë të lëshuara nga subjekte të paakredituara, si dhe nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumenteve të tenderit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues, si dhe në kuadër të shqyrtimit administrativ të ankesës, në mënyrë sa më transparente dhe të drejtë, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se për sqarimin e fakteve kërkohen verifikime të posaçme pranë organeve kompetente si Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, si institucioni i vetëm publik, i cili në bazë të ligjit nr. 116 datë 11.09.2014 “Për Akreditimin e Organeve të Vlerësimit të Konformitetit në Republikën e Shqipërisë” në nenin 4 të tij thuhet se “Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit është i vetmi organizëm kombëtar që kryen akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit”. Nga verifikimi në ëeb-in <http://dpa.gov.al/organe-te-akredituara/> konkretisht trupës certifikuese AQScert me kod CS008 me fushë akreditimi Organizem qe operon ne certifikimin e sistemeve te menaxhimit sipas SSH ISO/IEC 17021-1:2015, me datë përfundimi të akreditimit 27.03.2026, rezulton, se në listën e fushave të akreditimit për të cilat është i vlefshëm akreditimi i kësaj trupe, nuk figuron i akredituar për EN ISO 3834-2:2021 Kërkesat e cilësisë për saldimin me shkrirje të materialeve metalike, pra kjo trupë certifikuese nuk është e akredituar për EN ISO 3834-2:2021 Kërkesat e cilësisë për saldimin me shkrirje të materialeve metalike, por është e akredituar për kryerjen për “ 1- Akreditohet si organizëm

çertifikimi sistemi menaxhimi që certifikon sistemet e menaxhimit të pajisjeve mjekësore në përputhje me: ISO 13485:2016; 2- Akreditohet si organizëm çertifikimi sistemi menaxhimi që certifikon sistemet e sigurisë së shëndetit në punë në përputhje me: ISO 45001:2018; 3- Akreditohet si organizëm çertifikimi sistemi menaxhimi që certifikon sistemet e menaxhimit të pajisjeve mjekësore në përputhje me: ISO 13485:2016; 4- Akreditohet si organizëm çertifikimi sistemi menaxhimi që certifikon sistemet e menaxhimit të energjisë në përputhje me: ISO 50001:2018; 5- Akreditohet si organizëm çertifikimi sistemi menaxhimi që certifikon sistemet e menaxhimit të cilësisë në përputhje me: ISO 9001:2015; 6- Akreditohet si organizëm çertifikimi sistemi menaxhimi që certifikon sistemet e menaxhimit të ambjentit në përputhje me: ISO 14001:2015; 7- Akreditohet si organizëm çertifikimi sistemi menaxhimi që certifikon sistemet e menaxhimit të shërbimeve të teknologjisë së informacionit në përputhje me: ISO/IEC 20000-1:2018; 8- Akreditohet si organizëm çertifikimi sistemi menaxhimi që certifikon sistemet e menaxhimit të vazhdimësisë së biznesit në përputhje me: ISO 22301:2019; 9- Akreditohet si organizëm çertifikimi sistemi menaxhimi që certifikon sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit në përputhje me: ISO/IEC 27001:2013; 10- Akreditohet si organizëm çertifikimi sistemi menaxhimi që certifikon sistemet e menaxhimit antirryshfet në përputhje me: ISO 37001:2016; 11- Akreditohet si organizëm çertifikimi sistemi menaxhimi që certifikon sistemet e menaxhimit të trafikut rrugor në përputhje me: ISO 39001:2012; 12- Akreditohet si organizëm çertifikimi sistemi menaxhimi që certifikon sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit në përputhje me: ISO/IEC 27001:2022; 13- Akreditohet si organizëm çertifikimi sistemi menaxhimi që certifikon sistemet e menaxhimit të sigurisë ushqimore në përputhje me: ISO 22000:2018; Akreditohet si organizëm çertifikimi sistemi menaxhimi që certifikon sistemet e menaxhimit të qëndrueshmërisë së ngjarjeve në përputhje me: ISO 20121:2012;.

Për sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimes me dokumentacionin e paraqitur, nuk e përmbush kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në shtojcën 8/2 të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, “kriteret e veçanta të kualifikimit”, “kapaciteti teknik” pika 2.3.10, pasi certifikata EN ISO 3834-2:2021 e paraqitur nga të dy anëtarët e bashkimit është lëshuar nga një trupë certifikuese e cila nuk është e akredituar për lëshimin e kësaj certifikate. Pra për faj të vetë operatorit ekonomik nuk është arritur të përmbushet kriteri i sipërcituar. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se për sa kohë ekzistojnë laboratore të akredituara kombëtar ose ndërkombëtar për fushën e akreditimit për certifikatën EN ISO 3834-2:2021, dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Erald” SHPK & “Lis Konstruktion” SHPK në procedurën e prokurimit objekt - shqyrtimi, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe si i tillë nuk konsiderohet i vlefshëm, si dhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit. Në mënyrë eksplicite ligji për prokurimin publik parashikon, se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. KPP thekson, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me

kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili për zgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues është në kushtet e mospërbushjes së kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit objekt - ankimimi.

III.2.14. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë “Erald” SHPK & “Lis Konstruktion” SHPK do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor, deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 75 i LPP-së. Në nenin 75, pika 1 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se “*[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit.*

Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit [...]. Komisioni gjykon se është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me kriteret dhe kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, për sa kohë që i kanë pranuar ato dhe nuk i kanë bërë në asnjë rast objekt-ankimimi.

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Klame” SHPK & “Kevin Konstruktion” SHPK qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Klame” SHPK & “Kevin Konstruktion” SHPK, mbi kualifikimin e padrejtë të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Erald” SHPK & “Lis Konstruktion” SHPK, gjykojmë, se referuar pikave III.1., III.2. dhe III.3. të vendimit, gjendja faktike dhe juridike e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Erald” SHPK & “Lis Konstruktion” SHPK, do të ndryshojë duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, duke përmbushur kështu interesin e ankimuesit, rrjedhimisht pretendimet e tjera të ngritura nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Klame” SHPK & “Kevin Konstruktion” SHPK, nuk do të merren në shqyrtim, në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik

Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Klame” SHPK & “Kevin Konstruktion” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar, me Nr. REF-24857-10-16-2024, me objekt: “Arredim/mobilim i ambjenteve të brendshme të godinave (Fakultet dhe mensë-kuzhinë) të Kampusit të Ri të Akademisë së Forcave të Armatosura” me fond limit 110.154.899 (njëqind e dhjetë milion e njëqind e pesëdhjetë e katër mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH ose 1.115.041 (një milion e njëqind e pesëmbëdhjetë mijë e dyzet e një) euro pa TVSH, zhvilluar në datën 30.12.2024, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
 2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Erald” SHPK & “Lis Konstruktion” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e skualifikuar këtë bashkim operatorësh ekonomikë.
 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Klame” SHPK & “Kevin Konstruktion” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik
 7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Florent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri

